



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdrastva - Ministry of Health

Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine, datë: 16.01.2025

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Ministrisë së Shëndetësisë, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkeses për ri-shqyrtim** të datës 16.01.2025 të parashtruar nga Operatori Ekonomik ERK CONSTRUCTION INC Dega në Kosovë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Ndërtimi i QKMF në Shtime”, me nr. prokurimi 206-24-185-5-1-1, nxjerr:

V E N D I M

- I. **Refuzohet**, si e jashtafatshme kërkesa për rishqyrtim e OE ERK CONSTRUCTION INC Dega në Kosovë, e datës 15.01.2025, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Ndërtimi i QKMF në Shtime”, me nr. prokurimi 206-24-185-5-1-1, kundër Njoftimit për Kontrate të datës 19.12.2024 të publikuar në platformën elektronike;
- II. **Vërtetohet**, Njoftimi për Kontratë, i datës 19.12.2024.
- III. Ankesa e operatorit ekonomik ankues nuk mund të shqyrtohet, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor dhe AK-MSh vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatorët Ekonomik ERK CONSTRUCTION INC Dega në Kosovë, me datën 15.01.2025 kanë parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i QKMF në Shtime”, me nr. prokurimi 206-24-185-5-1-1. Autoriteti Kontraktues, me datë 16.01.2025, e ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimet ankimore të OE ankues:

- Neni 1 – Qëllimi,
- Neni 6 - Ekonomiciteti dhe Efikasiteti, Neni 7 – Barazin në trajtim /Jo -diskriminimi
- Neni 51 – Njoftimi i kriterëve të perzgjedhjes,
- Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve
- Neni 60 – Kriteret për dhenje të kontratës
- Neni 69 – Aftësia Teknike dhe Profesionale

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Bazuar ne nenin 17.12 të rregullores për prokurim publik nr. 001/22 AK gjatë përgatitjes së dosjes së tenderit duhet të përfshihen të gjitha informatat relevante dhe poashtu çdo fjali në dosje të tenderit do të përpilonte mirë pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit OE do të krijojë tenderët e tyre. Shih nenin 17.12 "Në dosjen e tenderit AK do të deklaron të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që OE-të të interesuar duhet të dinë për përgatitjen e tenderëve pa kërkuar informata shtesë. Informata të tilla do të përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, metodologjitë, kushtet e kontratës, vizitat në lokacion ose takime para-tenderuese etj. të lidhura me procedurat e dhënies së kontratës. Çdo fjali në dosjen e tenderit do të përpilohet mirë, pasi që dosja e tenderit është materiali themelor, në bazë të cilit Operatorët ekonomik do të krijojnë tenderët e tyre. Dosja e tenderit do të përgatitet në mënyrë të tillë, që – si rregull parimor – të mos ketë nevojë për informata shtesë. Veçanërisht, autoriteti kontraktues duhet të ketë parasyshë, kur përgatitet dosja e tenderit, që mos të ketë komunikime, diskutime ose negociime në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve".

Lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **Ndërtimi i QKMF në Shtime**, me numer te prokurimit: **206-24-185-5-1-1**, te shpallur nga Autoriteti Kontraktues **Ministria e Shëndetësisë, parashtrojmë 2 pyetje:**

Tek Aneksi 7, Kriteret për dhënien e kontratës, tenderi ekonomikisht me i favorshëm në drejtim të nënkriterit nr. 2. Garancioni i punëve (1-10) vite. Pyetja nr. 1.

Kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues te na sqaron se si kuptohet nenkriteri nr. 2. Garancioni i punëve (1-10) vite, pra te bëhet shkallezimi per secilin vit me nga sa pikë është poentimi.

Pra kerkojmë qe te modifikohet dosja e tenderit dhe te specifikohen saktë vitet me pikët apo poentimin apo te na jepni sqarime se si bëhet poentimi per 1 vit, 2 vite, 3 vite e keshtu me radhë dhe dersi kompanite e sigurime nuk leshojnë garancion me shume se 3 vite qysh e keni menduar ju garancionin deri ne 10 vite.

Pyetja nr. 2.

Tek Aneksi 1 Specifikimet teknike te detyrueshme shënon:

Shenim: AK ka vendosur afatin kohor, konform normave dhe standardeve ndërtimore, si dhe ndarjeve buxhetore, ku është vlerësuar afati për implementim të këtij projekti max. 30 muaj.

Sqarim:

Afati kohor i planifikuar i përfundimit te tërësishëm te punimeve përfshirë pranimin e përkohshëm te punimeve dhe pranim-dorëzimin e objektit duhet te jete jo me shume se 24 muaj kalendarik

Pyetja 2.

Te na sqaroni se cila mbetet valide, a jo ku thuhet afati per implemetin te projektit eshtë max. 30 ditë, ndersa më poshtë shënon që afati kohor i planifikuar i përfundimit te tersishem te punimeve dhe pranim- dorezimit duhet te jete jo me shume se 24 muaj kalenderit.

Nga kjo shihet se ka kunderthenje njera me tjetrën, prandaj kerkojme nga autoritetin kontraktues qe te na jep sqarimin e mundshem dhe mos ta lejon me dy opcione dhe pastaj te beje edhe korrigjimin e dosjes se tenderit.

Dëmet materiale: Përgatitja e ankesës për përpilimin e pyetjeve

Pergjigjia e Autoritetit Kontraktues ne lidhje me Kerkesen per Rishqyrtim te OE ankues:

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Ligji i Prokurimit Publik në bazë të nenit 108/A – Zgjidhja e mosmarrëveshjeve, para 3. i cili thekson:

"3. Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme:

Operatori Ekonomik ankues ka dorezuar Kerkese per rishqyrtim me daten 10.01.2025, ndersa hapja e ofertave fillimisht eshte parapare me daten 13.01.2025.

Duke u bazuar në dispozitat e nenit 108/a par.3 dhe 3.2. OE ankimor ka lëshuar afatin ligjor (ius strictum) për të parashtruar ankesë pasi që ka parashtruar ankesë pas afatit të fundit të lejuar 5 dite para dorëzimit të ofertave.

Nenin 60.1(a) i Rregullave të prokurimit publik

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Nenin 63.2 i Rregullave të prokurimit publik

Vendimi mbi refuzimin ose miratimin është obligativ dhe do të publikohet në sistem të prokurimit elektronik nga Zyrtari Përgjegjës i prokurimit. Në rastet kur zyrtari përgjegjës i prokurimit nuk nxjerrë vendim në lidhje me kërkesën për shqyrtim dhe nuk njofton operatorin ekonomik për afat shtesë, Operatori Ekonomik ka të drejtë që të parashtror një ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit pas skadimit të afatit prej 3 (tre) dite pune nga data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim. Në kalkulim të afateve kohore data e dorëzimit të kërkesës për rishqyrtim është dita (0).

AK-MSH e hedh poshtë ankesën e parashtrua në përputhje me nenin 108/a i LPP-se paragrafi 8.1 cili nën përcakton se:

~~Autoriteti kontraktues do ta refuzojë një kërkesë për rishqyrtim kur: 8.1 kërkesa nuk dorëzohet brenda afateve kohore të përcaktuara në paragrafin 3 të këtij neni.~~

SQARIM SHITESË:

Edhe pse kërkesa juaj është e jashtafatshme, për korrektesë dhe ndihmesën tuaj po ju sqarojmë si në vijim:

Fillimisht përmbajtja e kërkesës tuaj për rishqyrtim me shumë është kërkesë për sqarime shitesë, se sa kërkesë për rishqyrtim.

Ju keni bërë pyetje bazike të cilat janë të rregulluara me legjislacionin e prokurimit, andaj konsultojë RREGULLOREN Nr. 001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK, Nenin 27 Kriteret e Dhënies së Kontratës.

Sa i përket nënkriterit nr. 2. Garancioni i punëve (1-10) vite, tenderi është ekonomikisht më i favorshëm, me dy nënkritere Çmimi peshohet 80% ndërsa Garancioni i punimeve (nga 1 deri 10 vite).


Secili OE mund ta ofroj periudhën garantuese të punimeve nga 1 deri në 10 vite (psh: 1 vit, 2 vite, 3 vite etj), dhe me se shumti merr poena oferta që ka garancionin me të gjatë.

Sa i përket afatit për implementim të këtij projekti max. 30 muaj, po është e specifikuar qartë se punët duhet të kryhen max. për 30 muaj – Plani dinamik për kryerjen punëve nga fillimi deri në fund të pranimit.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimit të këtij vendimi.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit